



# Mediat e reja për fëmijët e moshës së shkollës fillore

Mediat e reja si kompjuteri, interneti dhe telefonat celularë, por edhe televizioni janë shumë joshëse për fëmijët në këtë moshë. Por ata së pari duhet të mësojnë si t'i përdorin mediat në mënyrë racionale dhe me përgjegjësi. Prindërit mund të bëjnë shumë në këtë drejtim.

## Pikat kryesore shkurtimisht:

Shoqëroni dhe mbështetni fëmijët tuaj në përdorimin e mediave. Fëmijët ende nuk kanë aftësi për t'u orientuar vetë në internet apo në botën joshëse të televizionit. Sigurisht që është një sfidë e madhe dhe kërkon kohë dhe mund për t'i shoqëruar fëmijët në udhëtimet tyre në mediat e reja dhe për t'i mbështetur aty ku është e nevojshme. Por pikërisht në këtë moshë ju mund t'ua përcaktoni drejtimin fëmijëve tuaj për një qasje me përgjegjësi dhe me një sy kritik në botën e mediave.

Merruni seriozisht me mediat e reja. Kush dëshiron t'i shoqërojë dhe mbështesë fëmijët duhet së pari ta dijë se për çfarë bëhet fjala. Fëmijët i përdorin mediat ndryshe nga të rriturit dhe ata përdorin aplikacione tjera. Mësoni se cilat media, programe televizive ose lojëra kompjuterike i preferojnë fëmijët tuaj më së shumti në mënyrë që ju të mund ta formoni mendimin tuaj për to. Zgjeroheni kompetencën tuaj mediatike ku është e nevojshme dhe përcilleni tutje këtë kompetencë të fëmijët tuaj. Sepse kompetenca mediatike është garancia e vetme për një përdorim pozitiv, të dobishëm dhe të sigurt të mediave - madje edhe jashtë shtëpisë.

Flisni me fëmijët tuaj në lidhje me mediat e reja. Vetëm ata të cilët e dinë se si fëmijët i përjetojnë mediat e reja mund t'i mbështesin dhe ndihmojnë në mënyrë efektive fëmijët e tyre. Për këtë shkak pyetni fëmijët tuaj se çka u intereson atyre, çfarë u pëlqen, çfarë preferojnë ata dhe çka dëshirojnë të zbulojnë dhe të mësojnë. Flisni edhe për përvojat tuaja personale, idetë dhe pikëpamjet tuaja në lidhje me mediat e reja – si për përvojat pozitive ashtu edhe për ato negative.

Mbroni fëmijët tuaj. Fëmijët në moshën e shkollës fillore kanë ende nevojë për siguri dhe mbrojtje përkatëse. Rreziqet në internet mund të zvogëlohen mjaft shumë përmes disa mjeteve të thjeshta ndihmëse. Këto përfshijnë masat teknike të tilla si softuerët për mbrojtjen e fëmijëve, softuerët për filtrimin e internetit apo për kufizimin e përmbajtjeve dhe aktiviteteve në kompjuter. Por mos harroni se fëmija juaj ka qasje në mediat e reja edhe jashtë shtëpisë. Masat teknike për mbrojtje nuk janë të instaluar gjithkund. Kjo është arsyeja pse është shumë me rëndësi që t'i tregoni fëmijës se ku mund t'i kanosen rreziqet. Fitojeni besimin e fëmijës tuaj në mënyrë që ai të mund t'ju drejtohet juve për problemet.

Përcaktoni bashkë rregullat e përdorimit të mediave. Vendosni së bashku me fëmijën tuaj se çka lejohej, vendosni edhe për kohëzgjatjen dhe vendin e përdorimit të mediave dhe për pasojat e mosrespektimit të rregullave. Rregullat për përdorimin e mediave ua japin fëmijëve një komizë solide dhe në këtë mënyrë parandalohen diskutimet e shumëpërsëritura dhe rraskapitëse. Duke u rritur fëmija juaj do të jetë në gjendje të marrë më shumë përgjegjësi. Prandaj përshtatni rregullat për përdorimin e mediave vijimisht. Më shumë informata mund të gjeni në fletëpalosjen tonë "Rregullat e përdorimit".

Caktoni kufijtë e përdorimit të mediave. Nuk është çdo gjë që e ofrojnë mediat e reja dhe televizioni e përshtatshme për fëmijët. As përdorimi i mediave me orë të tëra në çdo kohë të ditës nuk është i përshtatshëm. Për këtë ja disa këshilla:



- Kini parasysht që përmbajtja e mediave t'i përshatet moshës së fëmijës: evitoni temat komplekse, të ndërlikuara dhe të mbushura me probleme ose shoqërojeni fëmijën tuaj në këtë rast. Mbani parasysht kufirin e moshës. Të evitohet dhuna reale dhe realiste.
- Paraprakisht e përcaktoni se cilat programe në TV, cilat faqe në internet dhe cilat lojëra kompjuterike janë të lejuara etj.
- Televizori, kompjuteri dhe interneti nuk e kanë vendin në dhomën e fëmijëve.
- Telefonat celularë nuk janë të domosdoshëm në këtë moshë. Telefonat celularë që shërbejnë edhe për internet mund t'i kenë në dispozicion vetëm të rinjtë. Për të kontrolluar shpenzimet përdorni ofertat me parapagim.
- Rrjetet sociale si Facebook nuk janë të përshatshme për fëmijë të moshës së shkollës fillore. Chat të lejohet vetëm në chat për fëmijë.
- Kufizimi i përdorimit të mediave:

Fëmijët 6 deri në 9 vjeç: 30-45 minuta në ditë, maksimum 1 orë në ditë

Fëmijët deri 12 vjeç: 1 orë në ditë, maksimum 1 1/2 orë në ditë

ose: Fëmijët duhet ta kalojnë kohën e lirë dy herë më shumë me njerëz realë, dhe me aktivitete të tilla si me sport ose duke luajtur se sa me mediat e reja.

- Kohën për përdorimin e mediave ta integroni praktikisht në orarin ditor. Programet televizive emocionuese ose lojërat kompjuterike emocionuese nuk janë të përshatshme para gjumit.

Merrni qëndrim në lidhje me këtë çështje. Tregoni fëmijës tuaj se çfarë nuk ju pëlqen në lidhje me përmbajtjet e caktuara në televizion ose internet. Shpjegoni fëmijës tuaj gjithashtu pse ju nuk dëshironi që ai t'i shikojë disa programe të caktuara televizive ose ta përdorë internetin pa kufizim.

Bëhuni shembull për fëmijën tuaj. Kushdo që shpenzon vetë shumë kohë në telefon, në kompjuter apo duke e shikuar televizorin do ta ketë vështirë që t'i mësojë fëmijët t'i përdorin mediat në mënyrë të kufizuar.

Tregoni fëmijës tuaj edhe anët pozitive të mediave të reja. Kushdo që i përdor mediat e reja në mënyrë kreative mëson shumë dhe argëtohet njëkohësisht. Fëmijët e moshës së shkollës fillore mundën - me pak ndihmë nga të rriturit - të bëjnë kartolina, t'i editojnë fotografitë, të bëjnë foto albume, të përpilojnë kuiz me tinguj, të rrëfejnë tregime (me fotografi), të prodhojnë radiodrama dhe filma të shkurtër ose të bëjnë reportazhe të shkurta.

---

Për informata të mëtejshme mbi edukimin mediatik, kompetencën mediatike, për rrjetet sociale, lojërat kompjuterike apo edhe për aspektet ligjore të përdorimit të mediave vizitoni faqen [www.elternet.ch](http://www.elternet.ch).

